



**VENDIM**

*Nr. 175, Datë 07.11.2016*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “M.C  
INERTE LUMZI” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “TUC” DHE “LUMZI”.**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma “a” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10, pika 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016; gjithashtu dhe neneve 15 dhe 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec ”Tuc” dhe “Lumzi”, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorit të Tregut,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.2; 4.1.3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.4 gërmat “b”, “c”, “d”, “e”, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Vërtetimin nga Gjykata dhe Prokuroria, (neni 9, pika 2 gërma “d”);
- Të dhënat teknike për Hecet, (neni 9, pika 4.1.1)
- Studimi i fizibilitetit, (neni 9, pika 4.1.4 gërma “a”)
- Pika e lidhjes dhe lejet nga institucionet e tjera, (neni 9 pika 4.1.5 gërmat “a”, “b”, “c”), do të njoftohet subjekti që në bazë të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”, t`i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licensimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Tuc” me fuqi të instaluar 4470 MW; Hec “Lumzi” me fuqi të instaluar 11000 MW dhe fuqi totale 15470 MW.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



---

Votimi i Bordit të ERE-s për,

*VENDIM*

*Nr. 175, Datë 07.11.2016*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “M.C  
INERTE LUMZI” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “TUC” DHE “LUMZI”.**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Petrit Ahmeti</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Maksim Shuli</b>	_____	_____